Breaking News: DVP Dibër/Kapet në flagrancë dhe vihet në pranga një shtetas që shiste lëndë narkotike kokainë në ambientet e lokalit të tij.

Komunikata

26/03/2026

Raporti I Ngjarjeve, 27 Mars 2026

Raporti i ngjarjeve, 27 mars 2026

Qarku Korçë / Finalizohet operacioni policor i koduar "Gorica".

Operacioni i zhvilluar si rezultat i bashkëpunimit të strukturave të DVP Korçë dhe Policisë Kufitare, nën drejtimin e Prokurorisë, për qëditjen e paligjshmërisë në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike.

Sekuestrohen 37 pako me lëndë narkotike cannabis sativa, me peshë totale rreth 34 kilogramë, vihen në pranga 2 shtetas grekë.

Në vijim të punës për paramadimin dhe qëditjen e aktivitetit kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike, strukturat e DVP Korçë në bashkëpunim me DVKM Korçë, nën drejtimin e Prokurorisë finalizuan operacionin e koduar "Gorica". Si rezultat i këtij operacioni u arrestuan në flagrancë shtetasit grekë:

-Th. K., 48 vjeç dhe A. M., 34 vjeçe, banues në Greqi.

Në bazë të informacioneve të sigurusra në mugë operative, se një automjet me targa greke do të trafikonte drejt Maqedonisë së Veriut, me destinacion final Greqinë, një asi me lëndë narkotike, janë organizuar shërbimet e Policisë të cilat bënë të mundur lokalizimin e automjetit të dyshuar dhe u vunë në ndjekje të tij.

Automjeti me drejtues 48-vjeçarin dhe pasagjerre shtetasen A. M., u paraqit në dalje të Pikës së Kalimit Kufitar Goricë dhe gjatë procedurave të kontrollit kufitar mbi bazën e analizës së riskut, automjeti u kalua për kontrol në vijën e dytë. Nga dyshimet e krijuara, shërbimet e Policisë Kufitare në bashkëpunim me autoritetet doganore, kaluan këtë automjet për kontrol më të detajuar në skanc ku si rezultat u gjetën të fshehura, në një vend që krijuar posaçërisht në pjesën e poshtme të mjetit, 37 pako me lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa, me peshë totale rreth 34 kilogramë.

Në vijim të veprimeve të para hetimore, nga strukturat e policisë u arrestuan në flagrancë dy shtetasit grekë të larpërmendur për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", kryer në bashkëpunim.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan rreth 34 kg me lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa, automjeti, dy aparate celulare dhe një shumë euroshi.

Vijojnë veprimet hetimore për identifikimin e personave të tjerë, të dyshuar si të implikuar në këtë veprimtari kriminale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçës, për veprime të mëtejshme.

DVP Shkodër/Finalizohet operacioni i koduar "Gaminator".

Zbulohet në Fushë Arëz, një lokal ku zhvillohej veprimtaria e paligjshme e lojërave të fatit.

Sekuestrohen 2 makineta, 1 pajisje kompjuterike, 1 celular dhe 140 000 lekë.

Arrestohet në flagrancë një 30-vjeçar, punonjës i lokalit.

Shpallen në kërkim 2 shtetas, të dyshuar si organizatorë të kësaj veprimtarie të paligjshme.

Strukturat e Seksionit për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, Seksionit të Mbështetjes Operacionale Hetimore të DVP Shkodër dhe shërbimet e Komisariatit të Policisë Pukë, në kuadër të kontrolleve për paramadimin dhe qëditjen e veprimtarive të paligjshme në fushën e lojërave të fatit, bazuar dhe në informacionet e siguruara në mugë operative, organizuan dhe finalizuan operacionin e koduar "Gaminator".

Gjatë operacionit të zhvilluar në qytetin e Fushë Arëzit, u konstatua se në ambientet e një lokali zhvillohej aktiviteti i kundërligjshëm i organizimit të lojërave të fatit.

Në vijim të veprimeve procedurale:

-u arrestua në flagrancë shtetasi P. P., 30 vjeç, banues në Fushë Arëz, punonjës i lokalit;

-u shpallen në kërkim shtetasit I. T., 30 vjeç dhe G. P., 39 vjeç, të dy banues në Tiranë, të cilët dyshohet se janë organizatorët e kësaj veprimtarie të paligjshme.

Gjatë kontrollit në lokal, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 2 makineta, 1 pajisje kompjuterike, 1 celular dhe 140 000 lekë që dyshohet se janë përfituar nga kjo veprimtari e paligjshme.

Punohet për kapjen e 2 shtetasve në kërkim dhe për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie të paligjshme.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

DVP Kukës

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kukës referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit:

-L V. M., 44 vjeç, pasi është konstatuar duke kryer punime ndërtimi, pa leje nga organet kompetente;

-P. B., 69 vjeç, pasi dyshohet se ka ndezur zjarr në tokën e tij, në fshatin Shishtavec, me qëllim djegjen e barishteve dhe si pasojë e përhapjes së flakëve është djegur një sipërfaqe pylli.

Specialistët e qarkullimit rugor të Komisariatit të Policisë Tropojë referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për një shtetas 17 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Durrës/Vijojnë operacionet e njëpasnjëshme për qëditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve.

Finalizohet pas disa javësh hetime, operacioni i koduar "Midnight".

Shiste Kokainë në qytetin e Durrësit, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 36-vjeçari.

Sekuestrohen një sasi lëndë e dyshuar narkotike Kokainë, e ndarë në dhjetëra doza me qëllim shitjen, që ia gjet të arrestuarit, automjeti dhe celulari i tij.

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Durrës, si rezultat i punës hetimore të kryer për disa javë, për qëditjen e veprimtarisë kriminale të shitjes së lëndëve narkotike, organizuan dhe finalizuan në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", operacionin e koduar "Midnight". Gjatë operacionit u kap dhe arrestua me flagrancë shtetasi:

-E. K., 36 vjeç, banues në Durrës.

Gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Policisë i gjetën atij, një sasi lëndë të dyshuar narkotike Kokainë të ndarë në 60 doza, me qëllim shitjen. Nga hetimet dyshohet se ky shtetas shiste Kokainë në qytetin e Durrësit.

Gjithashtu, gjatë operacionit u kap në flagrancë nga shërbimet e Policisë, me një sasi lëndë të dyshuar narkotike Kokainë, shtetasi B. O., 36 vjeç, banues në Durrës. Pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe procedurale, nisi procedimi penal për këtë shtetas.

Materialet procedurale për këto dy raste iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

Tiranë

Vijon operacioni i koduar "Stolen line".

Sekuestrohet 1 automjet me vlerë rreth 250 000 euro, i dyshuar i vjedhur në Gjermani.

Identifikohet dhe shpallet në kërkim 34-vjeçari që dyshohet se ka trafikuar automjetin, në Shqipëri, me qëllim shitjen.

Si rezultat i punës hetimore dhe operacionale, kryer në vijim të operacionit "Stolen line", me objektiv qëditjen e rasteve të trafikimit në Shqipëri, të automjeteve të vjedhura jashtë shtetit, specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme konstatuan një tjetër rast në këtë fushë.

Në vijim të veprimeve për këtë rast, u sekuestrua 1 automjet tip "Mercedes-Benz AMG G63", me vlerë rreth 250 000 euro, pasi nga verifikimet rezultoi i vjedhur në Gjermani.

Nga veprimet hetimore u identifikua dhe u shpall në kërkim shtetasi A. L., 34 vjeç, i cili dyshohet se e ka trafikuar këtë automjet, në Shqipëri, me qëllim shitjen.

Punohet për kapjen e 34-vjeçarit dhe dokumentimin e plotë të rastit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve arrestuan shtetasin K. K., 38 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" i gjetën një sasi lëndë të dyshuar narkotike Kokainë e cila u sekuestrua me cilësinë e provës materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Kibernetike punojnë për shoqërimin e shtetasit Y. K, pasi dyshohet se ka përndjekur dhe kanosur në anë të njëtjetre sociale shtetasen R. K.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2:

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen M. T, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj nuses së djalit të saj;

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për 2 shtetas të mitur pasi dyshohet se për motive të dobëta kanë goditur një tjetër shtetas të mitur;

-punohet për shoqërimin e shtetasit V. Gj, pasi dyshohet se ka vjedhur një shumë parash dhe disa sende me vlerë në banesën e shtetasës L. C.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:

-arrestuan shtetasin Xh. F., 35 vjeç, pasi gjatë muajit mars dyshohet se ka kryer 3 vjedhje. Gjatë kontrollit fizik ku gjet një sasi lëndë e dyshuar narkotike kanabis;

-ndaluan shtetasin F. H., 30 vjeç, pasi dyshohet se në menyrë të vazhdueshme ka kanosur shtetasin K. K dhe familjarët e tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4:

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. T, pasi ka kalëzuar shtetasja K. S, se ish-bashkëshorti i saj, në kundërshtim me vendimin e Gjykatës, ka marrë djalin e tyre pa e njoftuar;

-referuan materialet në Prokurori dhe shpallen në kërkim shtetasin E. D, pasi dyshohet se në bashkëpunim me një shtetas tjetër të paidentifikuar kanë kanosur shtetasit R. L dhe A. L, për motive të dobëta. Punohet për kapjen e shtetasit E. D dhe sqarimin e rethanave të rastit;

-referuan materialet në Prokurori dhe shpallen në kërkim shtetasin O. T, pasi dyshohet se për motive të dobëta ka goditur shtetasin A. Ç. Punohet për kapjen e shtetasit O. T dhe sqarimin e rethanave të rastit.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit Sh. Ç dhe A. Sh, pasi për motive të dobëta, janë konfliktuar fizikisht me njëri-tjetrin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen E. Xh, pasi dyshohet se në mënyrë të vazhdueshme ka kanosur shtetasen K. R.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit E. S dhe T. D, pasi për motive të dobëta, janë konfliktuar fizikisht me njëri-tjetrin.

Specialistët e qarkullimit rugor:

-në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Rinas kapën e ndaluan shtetasin Rr. K., 29 vjeç, pasi Gjykata e ka dënuar me 2 muaj burgim për veprën penale "Drejtim i automjetit në mënyrë të parreguli;

-arrestuan shtetasin L. S., 48 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur;

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin E. M, pasi dje, në Rrugën e Arbërit, ka humbur kontrollin e automjetit dhe automjeti ka dalë nga muga. Si pasojë është dëmtuar shtetasi E. M dhe pasagjeri i tij të cilët ndodhen në spital, jashtë rezikut për jetën.

-Më datë 25.03.2026, është çuar për njëkohësi shtetasja B. M, e cila aksidentalisht është dëmtuar në këmbë, gjatë punës në një subjekt. Pas marrjes së njëkohësi, ajo kaloi në banesë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

DVP Dibër

Vijojnë goditjet e njëpasnjëshme ndaj rasteve të shitjes së lëndëve narkotike.

Kapet në flagrancë dhe vihet në pranga një shtetas që shiste lëndë narkotike kokainë në ambientet e lokalit të tij.

Sekuestrohen sasi të lëndës narkotike kokainë, të ndara në doza gati për shitje, si dhe një shumë parash.

Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Bulqizë, bazuar në informacionet e siguurara në mugë operative për një shtetas që shiste lëndë narkotike në lokalin e tij në qytetin e Bulqizës, kanë organizuar punën dhe si rezultat, kanë ushtruar kontroll të befasishëm në këtë ambient.

Gjatë kontrollit fizik dhe në ambientet e lokalit të këtij shtetasi, u gjet një sasi lëndë e dyshuar narkotike kokainë, e ndarë në doza gati për shitje, si dhe një shumë parash, që dyshohet se janë përfituar nga kjo veprimtari e paligjshme.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit L. P., 20 vjeç, banues në Bulqizë, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Divjakë arrestuan shtetasin P. B., 25 vjeç, pasi ka thyer masën e sigurisë "Arrest në shtëpi".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:

-G. B., 51 vjeç, banues në Fier, pasi ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij, e cila u pajis me urdhër mbrojtjeje;

-E. K., 57 vjeç, banues në Fier, pasi ka kryer punime ndërtimi, pa leje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Lushnjë referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. K., 64 vjeç, banues në Lushnjë, pasi ka marrë disa orendi shtëpiake, nga banesa ku ka jetuar me qira, me pretendimin se janë të tijat.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent